




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep:	Nr Prot:
Dep: <i>D.P</i>	Br Prot:
Dep:	Prot No: <i>01-4547/11/a</i>
Res. i: /	Data:
Breg. i: /	Datum: <i>18.11.2011</i>
Nr. pages:	Date:
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 45 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.10.2011 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti i konfliktit të interesit me numër protokoli AKK –03-3028/11, për *z. Isa Mustafa – Kryetar i Komunës së Prishtinës*
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e Funkcionit Publik, me numër protokoli AKK-03-3028/11, është trajtuar me të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe procedurale (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).

Pas identifikimit të rastit me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit, Zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese (29.06.2011) të cilës zyrtari i lartë, i është përgjegjur me datën 14.07.2011 .

Në takimin e mbajtur mes zyrtarëve të Agjencisë dhe Zyrtarit të Lartë të përfshirë në këtë rast me datën 15.08.2011, Zyrtari i Lartë është njoftuar me të gjitha argumentet që tregonin për situatë konflikt interesi, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

Zyrtari i Lartë është pajtuar se situatës të cilës i referoheshim, në bazë të Ligjit përkatës, paraqet konflikt interesi. Më pastaj ne kemi sqaruar se cilat janë veprimet që zyrtari i lartë duhet t'i bëjë në mënyrë që ta shmangë situatën konflikt interesi në të cilën ndodhej .

Me datën 19.10.2011 Zyrtari i lartë është kontaktuar përsëri dhe nga ai është marr konfirmimi se ndryshimet janë bërë dhe ato do të na dërgohen së shpejti me shkrim në Agjencinë Kundër Korrupsionit – Divizioni për Konflikt Interesi.


Kjo ka ndodhur me datën 20.10.2011 kur kemi pranuar shkresën njoftuese me informacionet zyrtare nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) me ndryshimet e bëra mbi biznesin në fjalë (D.P. Nr.03-4065/11).

Prandaj në bazë të këtyre veprimeve të kryera u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të DP-së
- Shefit të Divizionit
- Zyrtarit të Lartë, Isa Mustafa,
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit



Hasan Preteni /